



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

22.05.2012

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Tërheqet nga privatizimi Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria "Tokë bujqësore Rogovë "SH.P.K. dhe Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria "Tokë bujqësore Nashec" SH.P.K.

Prishtinë- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga tenderi për privatizim Ndërmarrjen e Re Lavërtaria-Blegtoria "Tokë bujqësore Rogovë "SH.P.K. dhe Ndërmarrjen e Re Lavërtaria-Blegtoria "Tokë bujqësore Nashec" SH.P.K.

Këto ndërmarrje ishin paraparë të privatizohet me datë 30 maj 2012 përmes Valës 55 të privatizimit, ndërsa tërheqja nga tenderët është bërë për çështje kadastrale.

Lista e ndërmarrjeve që do të privatizohen përmes Valës 55 tani përmban 23 Ndërmarrje të Reja, të cilat do të privatizohen përmes metopdës Spin off i Rregullt.

Afati i fundit për parakualifikim për Valën 55 është dita e mërkurë, 23 maj 2012. Dita për dorëzimin e ofertave është caktuar data 30 maj 2012, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të ndërmarrjeve të parapara për shitje përmes Valës 55 të privatizimit:

Ndërmarrja e Re Reparti i Biçikletave Babush Sh.P.K - Prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga sipërfaqet embuluara që janë afërsisht 1300 m² dhe nga sipërfaqja totale e tokës së ofruar për shitje që është afërsisht 13705 m². Lokacioni është mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloj biznesi.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Nasalë Sh.P.K - Prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në afërsi të fshatit Nasalë, 16 km nga qyteti i Gjilanit. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 42389 m². Pjesa më e madhe e tokës është përdorur për kultivimin e grurit dhe të misrit.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Depoja Frigoriferi Shillovë Sh.P.K - Kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë një objekt njëkatësh 4322 m² si dhe tokën përcejellëse 9878 m², që së bashku përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 14200 m². Objekti i depos frigoriferi përbëhet nga 6 dhoma frigoriferi, me vëllim total prej 12880 m³. Lokacioni është në fshatin Shillovë (në afërsi të qytetit të Gjilanit) mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloji biznesi.

Ndërmarrja e Re Ndërtesa Administrative Elan Sh.P.K - përbehet prej tokës dhe objekteve, me lokacion afër marketit Albi Center në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-70202016-00560, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 01 ha 45 ari 76 m² (Ekzistojnë (2) objekte që do transferohen në Ndërmarrjen e Re me një sipërfaqe të përafërt prej , si dhe një tendë (montazh) me nje siperfaqe të përafërt prej 1012

m².

Ndërmarrja e Re Restaurant Ylli Sh.P.K - përbëhet nga objekti tregtar, me sipërfaqe prej rreth 242 m², me lokacion në qendër të Mitrovicës e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr . P-71208072-00548-1, komuna e Mitrovicës.

Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra në Prizren Sh.P.K. - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë tokë në sipërfaqe prej 129 dhe një pjesë të ndërtesës P+1 me bruto sipërfaqe prej rreth 258 . Sipas të dhënave zyrtare kadastrale sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës është 258 ndërsa sipas matjeve në terren kjo sipërfaqe është rreth 220 . Prona gjendet në qendër të Prizrenit, në rrugën Remzi Ademi 4, nr. 46, përballë Urës së Gurit. Prona i është dhënë me qira nga Banka për Biznes -BPB.

Ndërmarrja e Re Stacioni i Veterinarisë Mitrovicë Sh.P.K. - gjendet në Komunën e Mitrovicës ka sipërfaqe të përgjithshme prej 1804 m². Në kuadër të kësaj hapësire të përgjithshme ndodhet edhe ndërtesa me rreth 236 m² .

Ndërmarrja e Re Jugobanka Ndërtesa Kryesore Administrative në Mitrovicë Sh.P.K. - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë tokë në sipërfaqe prej 909 m², dhe dy ndërtesa (Ndërtesa kryesore Administrative në sipërfaqe të përafërt prej 2,364 m² dhe ndërtesa ndihmëse në sipërfaqe të përafërt prej 108 m²) që gjenden në qendër të Mitrovicës, në rrugën Mbretëresha Teutë, përballë Procredit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

Bankës dhe Palestrës së Sporteve. Ndërtesa Kryesore është e lirë ndërsa ndërtesa ndihmëse është e uzurpuar nga pala e tretë.

Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra në Klinë Sh.P.K - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë hapësirat për zyre në një sipërfaqe të përafërt prej 80.09 m² që gjendet në katin përdhes të ndërtesës për banim në qendër të Klinës, rruga Dëshmorët e Kombit p.n. Aktualisht një pjesë e zyrës i është lëshuar me qira Kompanisë Private “Hidromont” ndërsa pjesa tjetër është e uzurpuar nga Kompania Private “Kompakt”.

Ndërmarrja e Re Stacioni i Veterinës në Leposaviq Sh.P.K - janë të regjistruara në Listën Poseduese nr: 242, Zona Kadastrale Lesak, numri i parcelës 3076/0, (toka me sipërfaqe 532 m², ndërtesa me sipërfaqe 176 m²) dhe Listën Poseduese nr: 11 Zona Kadastrale Socanica, numri i parcelës 3187/1 (toka me sipërfaqe 762 m², ndërtesa me sipërfaqe 148 m²). Në total sipërfaqja është 1618 m² (toka 1294 m² dhe ndërtesa 324 m²).

Ndërmarrja e Re Beçuk Sh.P.K - përbehet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Beçuk e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-70202005-00069, zona kadastrale Beçuk, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 3 ha 55 ari 96 m² (35,596 m²).

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Dush Sh.P.K. - përfshinë kompleksin e tokës bujqësore në një hapësirë të përafërt 305 ha, 82 ari dhe 56 m² (3058256 m²) që shtrihet në Zonën Kadastrale Dush, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Jashanicë 2 Sh.P.K. - përfshinë kompleksin e tokës bujqësore në një hapësirë të përafërt 233 ha 09 ari dhe 34 m² (2330934 m²) që shtrihet në Zonat Kadastrale Dush dhe Jashanicë, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Binça 2 Sh.P.K. - përfshinë kompleksin e tokës bujqësore në një hapësirë të përafërt 239 ha, 17 ari dhe 95 m² (2391795 m²) që shtrihet në Zonat Kadastrale Binçë dhe Jashanicë, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Rilindja Libraria Gjakovë Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial një mundësi të fitoj lokalit afarist me sipërfaqe përafërsisht 71 m², e cila gjendet në qendër të Gjakovës, që ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale.

Ndërmarrja e Re Rilindja Libraria Deçan Sh.P.K. - përfshinë lokalit afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 76 m², sipas matjeve të



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

bëra në terren me metër shirit nga Njësia Kadastrale e AKP-së, lokali i cili gjendet në Sheshin Mentor Tolaj pa numër, në qendër të Deçanit ofron mundësi të mira për zhvillim të biznesit.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Llapashticë e Epërme Sh.P.K -

përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe prej përafërsisht 23026 m² (2 ha 30 ari 26 m²) e cila gjendet në zonën kadastrale Llapashticë e Epërme, në Komunën e Podujevës. Ndërmarrja e Re gjendet në zonën kadastrale Llapashticë e Epërme 30 km larg kryeqendrës Prishtina, ndërsa 10 km larg qytetit të Podujevës.

Ndërmarrja e Re Rekreaturs Sh.P.K. - përfshinë lokalitetin afarist me sipërfaqe prej përafërsisht 98 m² i cili gjendet në katin përdhës të ndërtesës shumëkatëshe në rrugën Nënë Tereza P+8, afër ndërtesës së Rektoratit në Prishtinë.

Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria “Baruthana” Sh.P.K. -

Lokacioni/prona për tu bartur në Ndërmarrjen e Re përfshin një sipërfaqe totale prej përafërsisht 178667 m² (17.86.67 ha). Prona gjendet në dy zona kadastrale, në Zonën Kadastrale Prizren dhe Zonën Kadastrale Dushanovë/Arbanë. Lokacioni (Ferma e Lopëve-Baruthana) ndodhet në Prizren dhe aktualisht është në shfrytëzim nga pala e tretë, i cili nuk ka kontratë valide mbi qiranë me N.Sh.-në.

Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria “Administrata e Vjetër” Sh.P.K.

- Lokacioni/prona për tu bartur në Ndërmarrjen e Re përfshin lokacionin afarist që ndodhet në kuadër të kompleksit afaristo-banesor me një sipërfaqe totale prej 513.13 m², ku përfshin një pjesë të bodrumit me një sipërfaqe prej 81.36 m², një pjesë të përdhësës me një sipërfaqe prej 36.39 m² dhe katin e parë me një sipërfaqe prej 395.38 m², që ndodhet në ngastrën kadastrale nr.2032-2 në emër të PIK “Progres-Export”-Prizren. Lokacioni afarist/administrata e vjetër ndodhet në rrugën “Adem Jashari” (ish-“Karl Marksi”) nr. 14 në qendër të qytetit të Prizrenit, përball Hotel “Theranda” dhe aktualisht është në shfrytëzim nga pala e tretë, i cili nuk ka kontratë valide mbi qiranë me N.Sh.-në.

Ndërmarrja e Re “Shitorja”-Vërmicë Sh.P.K. -

Lokacioni afarist/shitorja për tu bartur në Ndërmarrjen e Re sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-71813008-01186-0 (FP nr.1) dhe kopjes së planit të lëshuar nga ZKK-Prizren përshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 100 m², me kulturë ndërtësë. Lokacioni afarist/shitorja ndodhet në fshatin Vërmicë, rajoni i Prizrenit. Aktualisht lokacioni afarist/shitorja është e mbyllur.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Liria “Shitorja - Hoqë e Qytetit” Sh.P.K. - Lokacioni afarist/shitorja për tu bartur në Ndërmarrjen e Re sipas të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-71813081-02372-3 (FP nr. 406) dhe kopjes së planit të lëshuar nga ZKK-Prizren përshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 100 m², prej të cilave 60 m² me kulturë ndërtesë dhe 40 m² me kulturë oborr. Lokacioni afarist/shitorja ndodhet në fshatin Hoqë e Qytetit, rajoni i Prizrenit. Aktualisht lokacioni afarist/shitorja është e mbyllur.

Ndërmarrja e Re Liria “Prona në Jeni Mahallë” Sh.P.K. - Prona për tu bartur në Ndërmarrjen e Re sipas fletës poseduese nr. 5310 përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 584 m². Prona ndodhet në rrugën “Rrotullajt”, Jeni Mahallë në zonën primare të qytetit të Prizrenit.

FUND

Me respekt,

Arta Gosalci

Public Relations Officer

Privatisation Agency of Kosova

Phone: +381/038 500 400 extension: 1110

Email. arta.gosalci@pak-ks.org

Rr. Ilir Konushevi No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org